

APPLICATION OF THE READING COMPREHENSIVE STRATEGIES IN THE FIRST PRIMARY DEVELOPMENT CYCLE

Arbresha Zenki-Dalipi

Primary School "Ismail Qemali" - Gostivar, Republic of North Macedonia, arbresha.zenki@unite.edu.mk

Abstract: As a process that evolves and develops throughout life, literacy is the basic skill with which it begins and on which all formal education depends. The "instrument" in question represents academic ability which excludes only the recognition and decoding of letters. Reading, i.e. reading comprehension in contemporary pedagogical literature is explained as a progressive analytical-synthetic process that incorporates the components of literal recognition as a code, their relation, to the understanding of the meaning, namely the transaction that appears in the middle of the text and readers.

Supported by proven pedagogical practice and various researches in this field, it has been found that readers' change in metacognitive and strategic readers is achieved through the use of reading strategies. These conscious and unparalleled plans without which reading comprehension cannot achieve its objectives are explained as intentional ways with the opportunity for a metacognitive reader to apply appropriate strategies as conscious actions.

Given the fact that reading comprehension strategies and instructional reading lie in complementary relationships, the aim of this research is to study the level of application of reading comprehension strategies, as well as application efficiency and quality enhancement learning when applying the strategies in question.

In order to move within the overall framework of this research, which bases the analysis of the size and efficiency of the application of reading comprehension strategies, the research refers to the comparative data of two groups of students, respectively 180 students divided as experimental group (90 pupils) and controller (90 students). In addition to the data we possess from participatory research, we will use statistic methods to analyze the differences between the experimental group and the control to analyze the differences between the two groups above. In order to answer the questions on which the study is led, as relevant data, we also use the answers obtained from the questionnaires with assessment scale of 23 teachers.

In addition to helping to support the hypotheses raised, the obtained results also reflect the implications of the findings and the submission of other scientific questions that address this problematic. Sublimated results provide elaborated and justified suggestions.

Keywords: reading, reading comprehension, reading comprehension strategy

APLIKIMI I STRATEGJIVE TË TË KUPTUARIT E LEXIMIT NË CIKLIN E PARË ZHVILLIMOR TË ARSIMIT FILLOR

Arbresha Zenki-Dalipi

Shkolla fillore "Ismail Qemali" - Gostivar, Republika e Maqedonisë së Veriut,

arbresha.zenki@unite.edu.mk

Rezime: Si proces i cili evoluon dhe zhvillohet tërë jetën, shkrim-leximi është aftësi themelore me të cilën fillon dhe mbi të cilën varet i gjithë arsimi formal. "Instrumenti" në fjalë paraqet aftësi akademike e cila përjashton vetëm njohjen dhe dekodimin e shkronjave. Leximi, respektivisht të kuptuarit e leximit në literaturën bashkëkohore pedagogjike shpjegohet si proces progresiv e analitiko-sintetik që në vete ngërthen komponentë të njohjes së shkronjave si kod, lidhjen e tyre, deri në të kuptuarit e domethënies, gjegjësisht transaksionit që paraqitet në mes të tekstit dhe lexuesit.

Të mbështetur nga praktika e dëshmuar pedagogjike dhe hulumtime të ndryshme të kësaj fushe, është konstatuar se shndrimi i lexuesve në lexues metakognitiv dhe strategjik, arrihet nëpërmjet përdorimit të strategjive të leximit. Këta plane të vetëdijshme e të pashkëputshme pa të cilat të kuptuarit e leximit nuk mund të arrijë objektivat e saj, shpjegohen si mënyra të qëllimshme me mundësi që lexuesi i një niveli metakognitiv të aplikojnë strategji përkatëse si veprime të vetëdijshme.

Duke u nisur nga fakti se strategjitë e të kuptuarit të leximit dhe instruktimi i të njëjtës qëndrojnë në raporte komplementare, synimi këtij hulumtimi është të studiojë nivelin e aplikimit të strategjive të të kuptuarit të leximit, si dhe efikasitetin e aplikimit dhe rritjen e cilësisë së të nxëniet gjatë aplikimit të strategjive në fjalë.

Me qëllim që të lëvizim brenda kornizës përgjithësuese të këtij kërkimi që bazë ka analizën e përmasës dhe efikasitetit të aplikimit të strategjive të të kuptuarit të leximit, hulumtimi i referohet të dhënave komparative të dy grupeve të nxënësve, respektivisht 180 nxënës të ndarë si grup eksperimental (90 nxënës) dhe kontrollues (90nxënës). Përpos të dhënave që posedojmë nga hulumtimi participues, për të analizuar dallimet në mes dy grupeve të lartpërmendura do të përdorim metoda statistikore me të cilën do të elaborojmë rëndësinë e dallimeve midis grupit eksperimental dhe kontrollit. Për tu dhënë përgjigje të pyetjeve mbi të cilat edhe udhëhiqet studimi, si të dhëna relevante gjithashtu përdorim përgjigjet e fituara nga pyetësorët me shkallë të vlerësimit të të 23 mësimdhënësve.

Përpos që ndihmojnë në mbështetjen e hipotezave të ngritura, rezultatet e fituara gjithashtu reflektojnë në sjelle të konstatimeve dhe parashtrim të pyetjeve të tjera shkencore që ngërthen kjo problematikë. Rezultatet e sublimuara sigurojnë sugjerime të shtjelluara dhe justifikuara.

Fjalë kyçe: lexim, të kuptuarit e leximit, strategji të të kuptuarit të leximit

1. HYRJA

“Këta njerëz të vegjël e të mirë, nuk dinë sa kohë e sa mundim lypset që njeriu të mësojë e të lexojë. Mua për këtë më janë dashtë tetëdhjetë vite, dhe unë as sot e kësaj dite nuk mund të them se ia kam arritur qëllimit” – Gëte

Qysh prej kohës kur haset për herë të parë rreth vitit 1880 - 1885, termi shkrim-leximi definohet në mënyra të ndryshme, interpretime që në përgjithësi fillojnë nga të dekodimi i simboleve deri në të kuptuarit e të lexuarës. Përpjekja për të dhënë qartësime sa më detajuar dhe gjenerike rreth kuptimit të nocionit, UNESCO shkrim-leximin e specifikon si "aftësi për të identifikuar, kuptuar, interpretuar, krijuar, komunikuar dhe llogaritur, nëpërmjet përdorimit të materialeve të shtypura a shkruara të lidhura në kontekste të ndryshme. “Shkrim-leximi përfshin një vazhdimësi të të mësuarit për të mundësuar individëve për të arritur qëllimet e tyre, për të zhvilluar njohuritë e potencialin e tyre dhe për të kontribuar plotësisht në mjedis dhe shoqëri më gjerë” (Unesco Education Sector, 2004). Duke qenë se ky term vazhdimisht evoluon, orvatja për të mbuluar spektrin e gjerë të përkufizimeve, kuptimi i fjalës definohet si “Atributi shkrim-lexim është gjerë i pranuar si qëllimi kyç i arsimit në shkollimin e obliguar. Ajo i referohet shkathësisë për të shkruar e lexuar në nivel të duhur të rrjedhshmërisë” (Blake, D. & Hanley, V.,1995), edhe pse sipas Louton dhe Gordon theksohet se “nuk ka standarde universale për shkrim-lexim” (Lawton, D. & Gordon, V.,1996). Mu për këtë qëllim, preferohet aplikimi i strategjive të të kuptuarit të leximit, metoda që do të mundësojnë lexuesve të përpujë, organizojë dhe vlerësojë të lexuarit. Nga Aleksandër dhe Judy strategjitë e tilla shihen si “procedura të drejtuara kah qëllimi të cilat janë të qëllimisht të planifikuara dhe shkaktuara si ndihmë në rregullim, ekzekutim dhe vlerësim të detyrës” (Alexander, P. A., and Judy, J. E.,1988)

2. LEXIMI DHE TË KUPTUARIT E LEXIMIT

Si akt mjaft kompleks, leximi paraqitet si proces aktiv mendor i të kuptuarit të teksteve që përfshin pikëpamje psikologjike dhe fizike. Leximi paraqet përmbledhje të aftësisë për të proceduar, kuptuar dhe integruar kontekstin në njohuritë e mëhershme. Paraqet transaksion të përmbajtjes që nis nga dekodimi i simboleve (shkronjave/shenjave), që krijojnë lidhje mes të njohurës dhe të lexuarës me qëllim që të integrojë të kuptuarën në njohuri dhe mundësi për ta interpretuar. But për leximin thekson se “leximi paraqet më shumë se të kuptuarit e asaj që është e shkruar në letër. Format e reja e të mësuarit e leximit integrojnë të menduarit, kërkimin dhe lidhjen, si dhe komunikimin me tjerë” (But,D., Svorc, L.,2009). Harvey për leximin potencon se “Leximi kërkon një sulm dy anësh. Ajo përfshin goditjen e kodit alfabetik për të përcaktuar fjalët dhe të menduarit rreth këtyre fjalëve për të ndërtuar kuptimin” (Harvey, S., Goudvis. A.,2007). Komplexitetin e këtij procesi e sqaron poashtu Mustafa ku në mes tjerash thekson: “Të lexuarit paraqet një kompleks analitiko-sintetik të procesit mendor, që në të njëjtën kohë bashkon shumë komponentë si: dallimin e shkronjave si kod, si shenjë grafike, paraqitjen e saj si simbolikë në parafytyrimin akustik, drejtshqiptimin e tingullit të veçuar në fjalë, lidhjen e fjalëve në fjali, të cilat paraqiten me ritmin e të folurit natyror dhe në fund me të kuptuarit e përmbajtjes (domethënien)” (Mustafa, A., 2004). Kjo veprimtari shpjegohet gjithashtu nga pionieri i njohur i kritikës së leximit, Rosebalt i cili e sqaron leximin si transaksion që realizohet mes të lexuarës dhe leximit (Probs, E.,1985)

Për ti dhënë një sqarim sa më gjithëpërfshirës, Leverato për aktin e të lexuarit përfshin aftësinë perceptuese, manipuluese dhe të menduarin si pikëpamje psikologjike, pikëpamjen socialo-ekologjike të reflektuara nga mjedisi kohor/hapësinor, si dhe ato të aktiviteteve fizike. Duke theksuar se nuk ekzistojnë organe të destinuar për të njëjtin funksion, integrimin e këtyre pikëpamjeve M.Ch. Levorato i qartëson me thënien se gjatë të lexuarit lexojmë me sy, kokë, por edhe me të gjithë atë që kemi në bark.

Sqarimi formal i të kuptuarit të leximit si qëllim i vet veprimtarisë së të lexuarit pranohet si proces mental i qëllimshëm e interaktiv që ndodh përgjatë të gjithë procesit të lexuarit, dmth para, gjatë dhe pas. “Gjatë aktit të leximit, lexuesi ndërfit dhe gërsheton aftësitë njohëse (vëmendjen, kujtesën, aftësinë kritike e analitike, përfundimin e vizualizimin); motivimin (qëllimin dhe interesimin për leximin), njohurinë paraprake (fjalorin, përmbajtjen e aftësitë gjuhësore dhe njohuritë e strategjive të zhvillimit) dhe përvojën”. (Snow, C., 2002).

E sqaruar thjeshtë nga Goch dhe Tanner leximi përfaqësohet nëpërmjet një ekuacioni të thjeshtë:

Dekodimi (deshifrimi) X Kuptimi i gjuhës = Kuptimi i leximit (Gough,P.B., & Tunmer, W.E., 1986)

Zhvillimi i aftësisë për të kaluar nga dekodimi deri në nivelin më të lartë kognitiv, nënkupton kalimin nga një nivel në tjetër. Kjo lëvizje progresive realizohet atëherë ku lexuesi kalon nëpërmjet të lexuarit *prozaik, interpretativ* deri në *zbatues*. Niveli fillestar, respektivisht ai prozaik, përfshin dekodimin e kodit alfabetik apo simbolik. Involvimi i determinantëve tjerë fundamental si krijim i lidhjeve të lexuesit me të lexuarën, me mjedisin, fjalorin dhe attribute tjera individuale, reflektojnë në kalim të një niveli më të lartë, gjegjësisht të kuptuarit e të lexuarës me rreshtave, stadi interpretativ. Tejkalimi dhe përsosja e niveleve të lartpërmendura lejojnë kalim në nivelin zbatues (aplikativ). Arritja e lexuesit në këtë stad nënkupton zhvillimin e aftësisë për të kaluar kufijtë e të lexuarës, përkatësisht të arrijtë të implementojë idetë e autorit në situata të reja në jetë.

Mishiq leximin e paraqet si “shkathtësi që duhet të mësohet dhe të fitohet, e ajo mësohet dhe zhvillohet për vite me punë të vazhdueshme dhe sistematike, me ushtrime të vazhdueshme. Mësuesit dhe studentët duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë. Nuk mund të pritë sukses në menjëhershëm, por suksesi është arritshëm” (Mishiq, B.,1988). Ky qëndrim kushtëzon përfshirje të një game të gjerë të strategjive të cilët do të lehtësojnë tejkalimin e vështirësive gjatë procesit të transaksionit prej një niveli në tjetrin.

3. STRATEGJITË E TË KUPTUARIT TË LEXIMIT

Aftësia për të dekoduar, planifikuar dhe monitoruar të lexuarën në një nivel metakognitiv, lejon të emërtojmë individin lexues. Mundësia që të shëndrohet individi në lexues, paraqet aftësinë për përzgjedhje të një strategjie të përshtatshme e cila do ti kishte ardhur në ndihmë që e lexuara të kuptohet. Lexuesit e nivelit metakognitiv integrojnë një gamë të gjerë të strategjive si shtigje për të arritur deri në kuptim. “Strategjitë e të kuptuarit nuk janë më shumë se mjetet që lexuesit punësojnë në shërbim të ndërtimit të kuptimit nga teksti” (Pressley, M., & Collins Block, C., 2002) “Strategjia përfshin veprim njerëzor, e kjo është qëllim i orientuar, i qëllimshëm, i vetëdijshëm dhe sjellje e kontrolluar” (Dijk, T.,& Kintsch, W.,1983). Pearson strategjitë i emërton si “Plane të vetëdijshme dhe fleksibile që lexuesit zbatojnë dhe përshtatësin në një shumëllojshmëri të teksteve dhe detyrave” (Pearson, P. D., Roehler, L. R., Dole, J. A., & Duffy, G. G., 1992). Të njëjtat lejojnë dekodim të shkruarës, lidhjen e lexuesit me të lexuarën, të kuptuarit, identifikimin e ideve kryesore, analizë dhe sintezë të të lexuarës deri sa e kuptuara do të kalojë përtej të kuptuarit tekstual.

Aplikimi i strategjive të të kuptuarit ka për qëllim orientimin e lexuesit në pikat kyçe të të shkruarës në vend të detajeve të parëndësishme. Ata janë “plane apo metoda që mund të përdoren ose të mësohen për të lehtësuar aftësitë leximit. Metodatat e përdorura gjatë leximit kanë për qëllim determinizmin e domethënies së tekstit” (Адамческа, С., 1996), Për të pasur rolin promovues të aftësisë për sistematizim e zhvillim të shkathtësisë për lexim aktiv kritik, Shashai për strategjitë thekson se zgjojnë fantazinë dhe imagjinatën e fëmijëve, i vë ato në marrëdhënie më të mirë për të kuptuar përvojën që çdo libër paraqet një thesar të vërtetë dhe një " kuti magjike ", a në të njëjtën kohë vë në tundim kapacitetin e të gjithëve individualisht (Shashai, A., 2000) Të njëjtat qasje të qëllimshme zgjojnë kureshtjen, nxisin krijimin e lidhjeve, inkurajon parashtrimin e një sërë pyetjeve rreth të lexuarës, përkatësisht kontribuojnë në leximin aktiv dhe bashkëveprimin me tekstin, dmth., rrezatojnë kuptim thelbësor të leximit.

4. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Duke u nisur nga fakti se strategjitë e të kuptuarit të leximit dhe instruktimi i të njëjtës qëndrojnë në raporte komplementare, synimi këtij hulumtimi është të studiojë nivelin e aplikimit të strategjive të të kuptuarit të leximit, si dhe efikasitetin e aplikimit dhe rritjen e cilësisë së të nxënësve gjatë aplikimit të strategjive në fjalë. Në kuadër të trajtimit teorik të nocioneve themelore në literaturën pedagogjike, qëllimi parësor i këtij kërkimi i referohet hulumtimit të përmasës së aplikimit dhe efikasitetit të zbatimit të strategjive të të kuptuarit e leximit.

Për të ekzaminuar situatën reale dhe zbardhur problematikën në fjalë, do të udhëhiqemi me pyetje të cilët do të sigurojnë shtigje të sigurta. Skalitja e kërkimit realizohet të dhënave të grumbulluara kualitative dhe kuantitative.

Me qëllim që të lëvizim brenda kornizës përgjithësuëse të këtij kërkimi që bazë ka analizën e përmasës dhe efikasitetit të aplikimit të strategjive të të kuptuarit të leximit, shtjellimi i çështjeve do të orientohet nëpërmjet interpretimeve të dhënave komparative të dy grupeve të nxënësve, respektivisht 180 nxënës të ndarë si grup

eksperimental (90 nxënës) dhe kontrollues (90nxënës). Përpos të dhënave që posedojmë nga hulumtimi participues, për të analizuar dallimet në mes dy grupeve të lartpërmendura përdorëm metoda statistikore me të cilën elaborohet rëndësia e dallimeve midis grupit eksperimental dhe kontrollit. Për tu dhënë përgjigje të pyetjeve mbi të cilat edhe udhëhiqet studimi, si të dhëna relevante përdoren përgjigjet e fituara nga pyetësorët me shkallë të vlerësimit të Likertit të 23 mësimdhënësve pjesëmarrës në kërkim.

5. PYETJE TË HULUMTIMIT

Qartësimi i çështjes qendrore të vet hulumtimit synon të përgjigjet pyetjeve si kërkimit dhe udhëhiqet duke u mbështetur pyetjeve si më poshtë:

- A është përmasa e aplikimit të strategjive të të kuptuarit të leximit në nivel të duhur në ciklin e parë zhvillimor?
- A kanë mësuesit mungesë të njohjes së qasjeve bashkëkohore për të lehtësuar të kuptuarin e shkrim-leximit?
- A shfaqin mësimdhënësit motivacion dhe dëshirë për të inovuar instruktimin e shkrim-leximit me strategji të të kuptuarit e leximit?
- A sjellin efekte pozitive lidhur të kuptuarit e leximit përdorimi i strategjive në fjalë?


6. REZULTATE

Duke iu dhënë sa më shumë peshë përdorimit të qasjeve bashkëkohore të të kuptuarit të leximit, rëndësia e strategjive në fjalë merr përmasa gjithnjë edhe më të mëdha në literaturën pedagogjike. Aktualitetin e aplikimit të strategjive në sferën bashkëkohore të arsimit e zbardhim nga dy këndvështrime. Problemin e shtjellojmë nga këndvështrimi i mësimdhënësve si faktor direkt të kyçur dhe perspektiva e nxënësve si subjekte primare në procesin e arsimit. Theksojmë se problemit i qasemi gjithashtu duke grumbulluar të dhëna relevante nga vëzhgimi participues dhe të dhëna të sublimuara nga pyetësorët e mësimdhënësve.

Lidhur pyetjes: *A është përmasa e aplikimit të strategjive të të kuptuarit të leximit në nivel të duhur?* sipas të dhënave të grumbulluara nga vëzhgimi participues reflekton praktika në të cilën aplikimi i strategjive të të kuptuarit të leximit nuk është në nivel të duhur. Gjatë vëzhgimit gjatë kohës së realizimit të hulumtimit hasëm evidencë të vogël të zbatimit. Duke u nisur se gjatë kohës së realizimit të orëve me grupin eksperimental dhe kontrollues patëm qasje te portofoliot e nxënësve, në raport me konstatimin e sjellë i bashkëngjitet edhe mungesa e evidencës së praktikës së tillë në të kaluarën. Në dokumentacionin e kontrolluar të nxënësve hasen fakte minimale të cilat do të lejonin të verifikojmë aplikim të strategjive në praktikën e çdoditshme rutinore. Gjithashtu, është mjaft e rëndësishme përshtypja që krijohet gjatë instruktimit të kësaj praktike te grupi eksperimental. Gjatë kohës së instruktimit dhe realizimit të mësimin duke involvuar praktika të tilla vërehet se nxënësit kanë fare pak përvojë të tillë.



Për të verifikuar të dhënat, përkatësisht përshtypjet të njëjtës dileme, qasemi të dhënave për të analizuar përgjigjet e 23 mësimdhënësve të anketuar.

Graf.1 A përdorni strategji të të kuptuarit të leximit në praktikën Tuaj shkollore?





Sipas të dhënave të grumbulluara nga mësimdhënësit reflekton se është në përputhje me elaborimin sipas përshtypjeve nga vëzhgimi. Përdorimi 13,05% e mësimdhënësve mohojnë përdorimin e strategjive, 9 prej tyre, apo 39,13% pohojnë praktikën përkatëse. Grupi më i madh i mësimdhënësve, respektivisht 47,83% e tyre kanë qëndrim neutral ndaj çështjes së ngritur.

Graf.2 A kanë mësuesit mungesë të njohjes së qasjeve bashkëkohore për të lehtësuar të kuptuarin e shkrim-leximit?





Pas interpretimit të grafikut më lartë lidhur me pyetjen e ngritur del në pah niveli i njohjes së strategjive të të kuptuarit të leximit. Një përqindje mjaft e vogël e mësimitdhënësve, gjegjësisht 17,39% prej tyre deklarojnë se kanë njohuri rreth strategjive në fjalë, përdërisa numër prej 39,13% e mësimitdhënësve deklarohen se kanë pak njohuri. Vërehet nivel i lartë, 39,13% e tyre të cilat deklarohen se nuk kanë fare njohuri rreth strategjive përkatëse.

Graf.3. A shfaqin mësimitdhënësit motivacion dhe dëshirë për të inovuar instruktimin e shkrim-leximit me strategji të të kuptuarit të leximit?



Me qëllim që të qartësojmë çështjen e motivacionit dhe dëshirën për të inovuar mësimitdhënien e shkrim-leximit me strategjitë analizojmë grafikun e paraqitur më lartë. Në të qartë duket se kemi një kurbë pothuajse normale e cila anon nga negativja. Ndonëse 17,39% e mësimitdhënësve janë më entuziast dhe shprehin dëshirë për të inovuar mësimitdhënien me strategji bashkëkohore, 26,09% të tyre nuk kanë dëshirë e motiv për të ndryshuar praktikën e tyre të mësimitdhënies. Pjesa dërmuese e tyre, gjegjësisht 56,52% të mësimitdhënësve kanë qëndrim neutral.

Pyetja A sjellin efekte pozitive përdorimi i strategjive në fjalë në procesin e të kuptuarit të shkrim-leximit? është preokupimi parësor i këtij studimi. Për të zbardhur këtë problematikë u realizua kërkim me 180 nxënës të ndarë me përzgjedhje rastësore në dy grupe me nga 90 nxënës dhe emërtuar si grup eksperimental dhe kontrollues, nxënës të ciklit të parë zhvillimor. Nxënësit e grupit eksperimental ndoqën instruksione rreth përdorimit të strategjive të të kuptuarit të leximit, ndërsa grupi kontrollues nuk ndoq instruksione të tilla. Pas ndjekjes së orëve dhe realizim të ushtrimeve me anë të aplikimit të qasjeve në fjalë, u realizua testim i njëjtë për të dyja grupet. Me qëllim të shmangies së faktorëve të ndryshëm të cilët mund të ndikojnë në suksesin e nxënësve gjatë testimit, e njëjta u realizua me të njëjtat kushte hapësinore dhe kohore. Pas realizimit të testimit dolën rezultate si më poshtë të grumbulluara nga vëzhgimi participues. Realizimi mësimit gjatë të cilit u aplikuan strategjitë të të kuptuarit të leximit reflektoi se ishte dukshëm me atraktiv për nxënësit. Te to u vërejt kyçje aktive e shoqëruar me gjallëri dhe entuziazëm. Është e rëndësishme të theksohet se në aktivitete të instruara merrnin pjesë edhe nxënës më pak të angazhuar. Reagimi i tillë pozitiv i nxënësve rreth këtyre qasjeve bëri të mundur shpejt të konstatojmë se nxënësit u aftësuan që në mënyrë të pavarur të zbatojnë këtë praktikë, verifikim i cili bëri të mundur të realizojmë testimet e nxënësve. Sipas rezultateve të marra të nxënësve nga dy grupet, paraqiten rezultatet si më poshtë.



Sipas rezultateve më lartë duket qartë dallimi i rezultateve në mes grupeve. Nëse te grupi eksperimental saktë janë përgjigjur 72,28% të pyetjeve të testit, te grupi kontrollues rezultate pozitive kanë arritur 57,66% e nxënësve. Edhe pse në të dy grupet arrihet të tejkalohet mesatarja, dallimi në mes dy grupeve arrin përqindje prej 14,62%.

Të pyetur rreth rritjes së efektivitetit të të kuptuarit e leximit nëpërmjet aplikimit të strategjive të të kuptuarit të leximit, mësimdhënësit reflektuan në rezultate të analizuara me korrelacionin e Pearsonit,

Correlations

		Zbatimi i strategjive	Suksesi
Zbatimi i strategjive	Pearson Correlation	1	.958**
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	23	23
Suksesi	Pearson Correlation	.958**	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	23	23

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed).

Tab.1 Korelacioni i Pearson mbi rritjen e efektivitetit të të kuptuarit të leximit gjatë zbatimit të strategjive

Tabela më lartë pasqyron korrelacion prej 0,985 mes zbatimit të strategjive të të kuptuarit të leximit dhe suksesi e arritur të nxënësve me metodën e Pearson-it. Është mjaft e evidente korrelacioni me shtrirje pozitive gjë argumenton rritjen e suksesit të nxënësve me rritjen e zbatimit të strategjive.

7. DISKUTIM

Studimi i realizuar rreth aplikimit të strategjive të të kuptuarit e leximit në ciklin e parë zhvillimor të arsimit fillor nxori në pah aspekte të rëndësishme të shkrim-leximit fillestar. Konstatimet e sjella pasqyrojnë situatë reale të gjendjes të nxjerra nga të dhëna të grumbulluara nga këndqëndrime të shumta. Sipas të dhënave të grumbulluara nga mësimdhënësit mund të konstatohet se niveli i aplikimit të strategjive në fjalë nuk është i duhur. Paralelisht me këtë qëndrim, mësimdhënësit nuk shfaqin dëshirë e motivacion për të lehtësuar mësimin e shkrim-leximit me këta qasje, ndonëse vlerësojnë se veprimi i njëjtë ndikon pozitivisht në rritjen e suksesit të nxënësve.

Sipas të dhënave të sublimuara nga vëzhgimi participues, mund të konstatohet se nuk ka evidencë të mjaftueshme për aplikim të strategjive. Sjellja dhe reagimi i nxënësve pohon konstatimin në fjalë, edhe pse doli se është mjaft e mirëpritur prej fëmijëve të kësaj periudhe zhvillimore.

Verifikimit të saktësisë së konstatimeve të shpalosura i paraprijnë rezultatet e nxënësve të grupit eksperimental dhe kontrollues. Të njëjtat dëshmojnë se strategjitë e të kuptuarit të leximit ndikojnë në nxënie të materies, përkatësisht në të kuptuarit e të lexuarës.

Të dhënat e shpalosura në këtë hulumtim duhet të kenë karakter nxitës për kërkime të tutjeshme në fushën e pedagogjisë, institucionalizim të qasjeve bashkëkohore, organizime të trajnimeve të mësimdhënësve për aplikim strategjive në fjalë dhe njëkohësisht inkurajim të mësimdhënësve për aplikim.

LITERATURA

Адамческа, С. (1996), *Активна настава*, Скопје:Легис

Alexander, P. A., and Judy, J. E. (1988), The interaction of domain-specific and strategic knowledge in academic performance. *Review of Educational Research*

Blake, D. & Hanley, V. (1995), *Dictionary of Educational Terms*, Aldershot: Arena

But,D., Svorc, L., (2009), *Uspesno citanje i pisanje, tehnike za razvoj pismenosti*, Beograd: Kreativni centar

Dijk, T., dhe Kintsch, W., (1986), *Strategies of discourse comprehension*, Academic Press, New York

Gough,P.B., & Tunmer, W.E., Decoding, Reading and reading disability, *Remedial and Special education*, 7(1):6-10

Harvey, S., Goudvis. A., (2007), *Strategies that work :Teaching the comprehension for understanding and engagement*, Stenhouse Publishers

Lawton, D. &Gordon, V. (1996) *Dictionary of Education*, London: Hodder and Stoughton

Mishiq, B.(1988), *Nivo čitanja i teškoća u čitanju kod učenika i razreda*, Sarajevo: Naša Škola

Mustafa, A., Didaktika e gjuhës shqipe dhe e leximit letrar, 2004, Shkup:Logos

Pearson, P. D., Roehler, L .R., Dole, J. A., & Duffy, G. G., (1992) Developing expertise in reading comprehension te Samuels, S J. & Farstrup, A. E. (Eds.), *What research has to say about reading instruction (2nd ed.)*. Newark, Del.: International Reading Association

Pressley, M., and Collins Block, C. (2002). *Comprehension instruction: Research-based best practices* Guilford Press, New York

Probs, E., (1985), Transactional Theory in the Teaching of Literature, *Journal of aesthetic education* 20, no. 4 Yale University Press

Snow, C.(2002),*Reading for understanding*, Arllington:RAND

Shashai, A. (2000), *Nga të folurit në lexim*, Elbasan: Elbasani

Unesco Education Sector, (2004), *The Plurality of literacy and its Implications for Policies and Programmes*, France, /UNESCO